



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1310 /3 prot

Datë 19.06.2023

V E N D I M
Nr. 496 /2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.06.2023, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “IN PRINT” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-71290-06-01-2023 me objekt: “Sherbim Printimi”, me fond limit 2,433,297.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 12.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gjirokastrë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Gjirokastrë
Sheshi Çerciz Topulli, Gjirokastrë

Ankimues: “IN PRINT” SHPK
Lagjja 18 Shtatori, Rr. George Sorros, Gjirokastrë

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 02.06.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-71290-06-01-2023 me objekt: “Sherbim Printimi”, me fond limit 2,433,297.00 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 12.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gjirokastrë.

II.2. Në datën 07.06.2023 operatori ekonomik “IN PRINT” SHPK, ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik ankesën me nr. 1310 prot., ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimesit.

II.4. Me shkresën me numër 5450/1 prot., datë 13.06.2023 protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1310/2 prot., datë 15.06.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar, se ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe ka marrë vendimin për pranimin e plotë të ankesës.

II.5. Konkretisht, referuar informacionit më sipër konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur pranim plotësisht të ankesës si më poshtë vijon:

[...] 1. Në dokumentet standarde të tenderit me nr.REF71290-06-01-2023 kapaciteti ekonomik dhe financiar pika 2.2.2 kërkohet kritri si më poshtë vijon:

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021-2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur Janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "c", të ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e pro esionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasiv.

Për këtë ju pretendoni ndryshimin e tij duke e hequr si pikë ose duke hequr bilancin e vitit 2022.

Në bazë të Vkm nr.285, date 19.05.2022 "Per miratimin e rregullave të prokurimit Publik" neni 55 pika 4 citohet se:

Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duk: marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen : xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë llo procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40"o të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipa parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.

Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë:

a) Për kontratat e punëve:

i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30% të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ii, punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Gjithashtu

Në bazë të sistemit të QKB-së dhe Sistemit të E-Albania-s është nxjerrë njoftimi si më poshtë vijon:" Të nderuar subjekte,

Brenda datës 31 Korrik 2023, të gjitha subjektet konform ligjit duhet të depozitojnë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dokumentet e mëposhtme, në rastet kur mbajtja e tyre është detyrim:

Pasqyrat financiare vjetore Raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe Raportin e Auditimit

Pavarësisht formës së tyre ligjore, depozitimin e akteve të mësipërme duhet ta kryejë çdo subjekt i regjistruar në Regjistrin Tregtar, kur këto subjekte kanë detyrimin e hartimit të tyre.

Për sa më sipër pretendimi juaj qëndron dhe në bazë të dispozitave ligjore të sipërcituar Kapaciteti ekonomik financiar pika 2.2.2 do të hiqet.

2. Ju pretendoni se

Në Kapacitetin teknik pika 2.7 citohet se

2.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimit objekt-kontrate, duhet të disponojë minimalisht 2 persona të cilët duhet të jenë në listëpagesat e muajit Shkurt 2023 - Prill 2023.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punonjësit që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti enti kontraktori i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Ak ka kërkuar një numër prej 2 punonjësish por jo të certifikuar. Bazuar në Vendimin e Komisionit të Prokurimit nr 1280/2022 datë 22.12.2022, ju pretendoni se është i nevojshëm shtimi i të paktën një punonjësi të certifikuar nga prodhuesi ose ekuivalente.

Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. AK referuar ankeses së operatorit ekonomik, si dhe nga shqyrtimi i termave të referencës dhe specifikimet teknike, gjykon, se bazuar në kompleksitetin dhe volumin e kontratës objekt-prokurimi, kërkesa për disponimin e një "1 punonjësi të certifikuar nga prodhuesi që posedon ose ekuivalente me të. Me synim nxitjen e konkurrencës dhe sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, autoriteti kontraktor merë masa për modifikimin e këtij kriteri duke vendosur dhe togfjalëshin "Ekuivalente" për certifikime ekuivalente,

AK bazuar në pretendimin tuaj, vendimin e sipërcituar të KPP-së, numrin e lartë të pajisjeve që kërkon prej 34 (tridhjetë e katër) si dhe duke marrë parasysh dhe shpërndarjen e tyre në të 6 (gjashtë) njësitë administrative si dhe në të gjitha drejtoritë e Bashkisë Gjirokastër lind nevoja për një punonjës të certifikuar nga prodhuesi që posedon ose ekuivalente me të.

Për sa më sipër pretendimi juaj qëndron.

Për sa më sipër, në cilësinë Zyrtarit të Autorizuar të Autoritetit Kontraktor vlerësoj dhe vendos të pranojë plotësisht ankesën tuaj në bazë të nenit 114 të LPP-së.”

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar shkresës me numër 5450/1 prot., datë 13.06.2023 protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1310/2 prot., datë 15.06.2023, konstatohet se autoriteti kontraktor ka vendosur pranim plotësisht të ankesës si më poshtë vijon:

[...] 1. Në dokumentet standarde të tenderit me nr.REF71290-06-01-2023 kapaciteti ekonomik dhe financiar pika 2.2.2 kërkohet kriteri si më poshtë vijon:

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021-2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur Janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "c", të ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e pro esionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasiv.

Për këtë ju pretendoni ndryshimin e tij duke e hequr si pikë ose duke hequr bilancin e vitit 2022.

Në bazë të Vkm nr.285, date 19.05.2022 "Per miratimin e rregullave të prokurimit Publik" neni 55 pika 4 citohet se:

Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duk: marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen : xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40"o të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipa parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.

Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë:

a) Për kontratat e punëve:

i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30% të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ii, punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që

prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Gjithashtu,

Në bazë të sistemit të QKB-së dhe Sistemit të E-Albania-s është nxjerrë njoftimi si më poshtë vijon:” Të nderuar subjekte,

Brenda datës 31 Korrik 2023, të gjitha subjektet konform ligjit duhet të depozitojnë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dokumentet e mëposhtme, në rastet kur mbajtja e tyre është detyrim:

Pasqyrat financiare vjetore Raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe Raportin e Auditimit Pavarësisht formës së tyre ligjore, depozitimin e akteve të mësipërme duhet ta kryejë çdo subjekt i regjistruar në Regjistrin Tregtar, kur këto subjekte kanë detyrimin e hartimit të tyre.

Për sa më sipër pretendimi juaj qëndron dhe në bazë të dispozitave ligjore të sipërcituara Kapaciteti ekonomik financiar pika 2.2.2 do të hiqet.

2. Ju pretendoni, se:

Në Kapacitetin teknik pika 2.7 citohet se

2.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimit objekt-kontrate, duhet të disponojë minimalisht 2 persona të cilët duhet të jenë në listëpagesat e muajit Shkurt 2023 - Prill 2023.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punonjësit që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Ak ka kërkuar një numër prej 2 punonjësish por jo të certifikuar. Bazuar në Vendimin e Komisionit të Prokurimit nr 1280/2022 datë 22.12.2022 ju pretendoni se është I nevojshëm shtimi I të paktën një punonjësi të certifikuar nga prodhuesi ose ekuivalente.

Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në

funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. AK referuar ankeses se operatorit ekonomik, si dhe nga shqyrtimi i termave të referencës dhe specifikimet teknike, gjykon, se bazuar në kompleksitetin dhe volumin e kontratës objekt-prokurimi, kërkesa për disponimin e një “1 punonjësi të certifikuar nga prodhuesi që posedon ose ekuivalente me të. Me synim nxitjen e konkurrencës dhe sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, autoriteti kontraktor merë masa për modifikimin e këtij kriteri duke vendosur dhe togfjalëshin “Ekuivalente” për certifikime ekuivalente,

AK bazuar në pretendimin tuaj, vendimin e sipërcituar të KPP-së, numrin e lartë të pajisjeve që kërkon prej 34 (tridhjetë e katër) si dhe duke marrë parasysh dhe shpërndarjen e tyre në të 6 (gjashtë) njësitë administrative si dhe në të gjitha drejtoritë e Bashkisë Gjirokastër lind nevoja për një punonjës të certifikuar nga prodhuesi që posedon ose ekuivalente me të.

Për sa më sipër pretendimi juaj qëndron.

Për sa më sipër, në cilësinë Zyrtarit të Autorizuar të Autoritetit Kontraktor vlerësoj dhe vendos të pranojë plotësisht ankesën tuaj në bazë të nenit 114 të LPP-së.”

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

- a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;
- b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 2 e ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “IN PRINT” SHPK, lidhur me procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-71290-06-01-2023 me objekt: “Sherbim Printimi”, me fond limit 2,433,297.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 12.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gjirokastrë.
 2. Autoriteti kontraktor të publikojë shtojcën për ndryshimin e dokumenteve të tenderit në përputhje me vendimin e zyrtarit të autorizuar për shqyrtimin e ankesës të depozituar në KPP përmes shkresës me numër 5450/1 prot., datë 13.06.2023 protokolluar me tonën me nr. 1310/2 prot., datë 15.06.2023
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit të zyrtarit të autorizuar për shqyrtimin e ankesës.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “IN PRINT” SHPK.
 5. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri